

LEKSIONI 4

1. *Klasifikimi i fjalive pyetëse*
2. *Rendi i gjymtyrëve në fjalitë pyetëse*
3. *Fjalitë e ndërshtëna*
4. *Fjalitë e ndërkallura*

Klasifikimi i fjalive pyetëse

Fjalitë pyetëse ndahen në dy grupe të mëdha:

- a. *fjali pyetëse të mirëfillta.*
- b. *fjali pyetëse jo të mirëfillta.*

A. Fjalitë pyetëse të mirëfillta

Në këto fjali përmbahen pyetje të drejtpërdrejta, që u drejtohen bashkëbiseduesve për diçka të panjohur a të njohur jo plotësisht.

Këto fjali mund të klasifikohen më tej në bazë të kriterëve të ndryshme.

Për nga fakti se ku përdoren në monolog apo në dialog, dallohen :

- *fjalitë pyetëse dialogjike,*
- *fjalitë pyetëse monologjike.*

Fjalitë pyetëse dialogjike janë ato fjali me anën e të cilave folësi u drejtohet të tjerëve për të pyetur diçka që i intereson, si :

-Ku banoni ju? - Në qytetin e Tuzit.

Fjalitë pyetëse monologjike japin herë-herë përjetimet, dyshimet, luhatjet e personave. Mund të shprehin diçka reale apo të mundshme, ose mëdyshje, pasiguri, p.sh. :

Më vinte keq për të, po çtë bëja ?

Kush do ta varroste Uraninë, po të mos shkonte ai ?

Dallohen gjithashtu edhe

1. fjalitë pyetëse tërësore
2. fjalitë pyetëse të pjesshme.

1. Fjalitë pyetëse tërësore janë atëherë kur folësi kërkon të mësojëfakte që nuk i di ose që do të sigurohet për vërtetësinë e tyre. Pyetja përfshin gjithë përmbajtjen e fjalisë dhe i referohet kallëzuesit të saj. Fjalitë pyetëse tërësore dalin *pa fjali pyetëse*, po mund të marrin pjesëza pyetëse. Ato marrin përgjigje me fjalët: *po, jo, posi, jo se jo* etj., ose me një fjali dëftore në formë pohore ose mohore, që është fjalia pyetëse e rimarrë në mënyrë të plotë ose pjesërisht. Kjo rimarrje bëhet për të bërë më të qartë ose për të përforcuar përgjigjen:

(1) *Erdhën policët?* - e pyeta. – **Po**. Janë këtu.

Po flije? -**Jo**.

A mund t'ju bëj një pyetje? -**Posi**,tha ajo.

Do të shihemi? –i thashë. -Me kënaqësi.

Në fjalitë pyetëse tërësore mund të përdoren pjesëzat pyetëse: *a, vallë, mos, (a) thua* dhe bashkime të tyre: *mos vallë, (edhe mos..vallë)* dhe anasjelltas *vallë mos, vallë a, (a..vallë), a mos* etj..

Ndër këto pjesëza, pjesëza **a** është më e përdorshme, ka vetëm kuptim pyetës të përgjithshëm.

Vallë sjell nuanca dyshimi a pasigurie e mund të vendoset në krye, në mes e në fund të fjalisë.

Me pjesëzat *mos* dhe *(a) thua (se)* pyetet për fakte të ngjashme a të dyshimta. Folësi, sado që ka dyshim, është i prirur të besojë vërtetësinë e asaj për të cilën pyet. Dyshim shprehin edhe pjesëzat e bashkëlidhura *mos.. vallë* etj.

(2) *A e dini?*

Po ajo a është në vete?

Kaq e lehtë t'u duk ty, a?

*Do të zbardhë **vallë** drita?*

Përveç këtyre pjesëzave, në fjalitë pyetëse tërësore mund të përdoren edhe pjesëzat: *e, ë, a* me vlerë pyetëse-nxitëse. Ato zakonisht dalin në fund të fjalisë dhe shërbejnë për të nxitur bashkëbiseduesin të pohojë a të mohojë përmbajtjen e fjalisë. Një fjali pyetëse tërësore mund të shprehet vetëm me një nga këto pjesëza.

*(3) Ngjarje e papëlqyer Demkë, **ë**? – tha shoku Zylo.*

*Të kamarrë malli për ne këtej, **a**?*

*Qenke ngritur heret, **e**?*

***E**? Si shkoi puna? **E**? – pyeti me padurim.*

***A**? - bëri sikur nuk dëgjoi.*

2. Fjali pyetëse të pjesshme kemi atëherë kur folësi kërkon të dijë nga bashkëbiseduesi *një element të thënies që nuk e di*, autorin, objektin e veprimit, tiparin, rrethanat e veprimit. Të gjitha këto elemente të njohura jepen në fjali me përemra apo ndajfolje pyetëse: *kush, cili, ç', çfarë, sa, i sati, me se, ku, nga, kur, si qysh, përse, pse* etj., ose me sintagma që përmbajnë fjalë të tilla.

B. Fjalitë pyetëse jo të mirëfillta.

Ka edhe fjali pyetëse për nga forma, që nuk shërbejnë për të pyetur, por për të shprehur nxitje për veprim. Këto janë fjalitë nxitëse-pyetëse.

Ka edhe fjali që shërbejnë për të shfaqur me forcë, në mënyrë të gjallë, më shprehëse, një pohim a mohim, këto janë fjalitë pyetëse retorike.

Tipi më i zakonshëm i fjalive pyetëse jo të mirëfillta janë : **fjalitë pyetëse të zhdrejta**.

Ato dalin në formën e pjesëve të nënrenditura të fjalive të përbëra ftilluese e më rrallë të fjalive përcaktore. Ato varen nga folja e pjesës kryesore që tregon të thënë, të pyetur, informacion për diçka etj. Fjalitë pyetëse të zhdrejta mund të jenë :

a. tërësore

b. të pjesshme.

Në rastin e parë ato kanë në përbërje të tyre pjesëzat **a** (më rrallë **mos**) ose lidhëzat nënrenditëse **në, nëse**.

Kur dalin si fjali pyetëse të zhdrejta të pjesshme, përdoren po ato ndajfolje e përemra pyetës, si në fjalitë pyetëse të drejta, të prira ose jo nga lidhëza ftilluese **se**.

Fjalitë pyetëse të zhdrejta nuk kanë intonacion pyetës, ato i nënshtrohen intonacionit të pjesës kryesore dhe të fjalisë së përbërë në përgjithësi. Në fund të tyre vendoset shenja e pikësimit që kërkon pjesa kryesore.

(4) S'dihet se ç'sjell e nesërmja.

Ndaloj për të parë nëse po flisnin apo e dëgjonin.

Ne dinim për ku po shkonim.

Lexuesi do të kërkonte të mësonte si u ndërtua një vepër kaq e madhe, çfarë njerëzishishin ato që e ndërtuan dhe ç'metoda përdorën.

Pyetja se nga e dinte këtë gjë, ai s'iu përgjigj.

Dëgjo ç'më ndodhi dje.

Pyete ku do të shkojë.

Ae dini pse jemi mbledhur sot këtu?

E dini ju seç ndodhi në atë kohë?

2 Rendi i gjymtyrëve në fjalitë pyetëse

Fjalitë pyetëse, siç thamë, karakterizohen nga fjalë të veçanta, nga pjesëza pyetëse dhe ndajfolje e përemra pyetës. Pjesëzat zënë pozicione të ndryshme në fjali: në krye, në mes ose në fund të fjalisë. Mund të dalin edhe dy pjesëza njëkohësisht ose një pjesëz dhe një fjalë tjetër pyetëse. Disa nga këto fjalë pyetëse e kushtëzojnë rendin, disa të tjera jo dhe rendi mbetet pak a shumë si në një fjali të thjeshtë dëftore.

(1) A erdhi kush?

E pse s'flisni:

- Mendje kërkoni të më jepni **a**?

Mos vallë kjo gjë do të rëndonte tepër?

Ku vallë ka shkuar?

Hë, a ka më?

Mos është kjo dobësi **vallë**?

Ndajfoljet dhe përemrat pyetës që karakterizojnë fjalitë pyetëse të pjesshme zakonisht vendosen në krye të fjalisë.

Po mund të dalë në krye edhe një fjalë tjetër, e cila shënon gjymtyrën që spikatet më tepër. Këto fjali dalin me skema strukturore të ndryshme, sipas varianteve të ndryshme stilistikore që shprehin.

(2) **Si** ndodhi kjo?

Cili je ti që më kërkon?

Ç'faj të kanë njerëzit?

Pse s'ma the që në fillim?

Po vajza **ku** është?

Po këtë shoqe **nga** e kemi?

Shtëpinë **me cilin** ta lë?

Po ti **ç'**kërkon këtu?

Po ju **cila** jeni?

Si rregull, kur fjalia pyetëse fillon me një ndajfolje pyetëse në funksion të rrethanorit, vjen më parë kallëzuesi pastaj kryefjala. (Përmbysja e rendit kryefjalë – kallëzues është karakteristike për fjalitë pyetëse në përgjithësi. Le të krahasohen fjalitë dëftore në gjegjëset pyetëse pa fjalë pyetëse:

Treni erdhi.

Erdhi treni?

Gjethet ranë.

Ranë gjethet?

Makina u prish.

U prish makina?

3. Fjalitë e ndërmjetme

Fjali e ndërmjetme është fjalia e përfshirë në një fjali tjetër apo në një periudhë, pa qenë organikisht e lidhur me të. Fjalitë e ndërmjetme shprehin kuptime modale e emocionale-shprehëse, burimin, sqarimin për mënyrën e thënies ose lidhjen logjike të mendimeve dhe shqiptohen me intonacion ndërmjetës.

- *Kishim ndryshuar, **kjo s'do mend**, po gjallëria e viteve të shkollës vlonte gjithnjë në zemrat tona.*
- ***Mirë thonë**, s'ka gjë më të shpejtë në botë se mendja e njeriut.*
- *Martirët e lirisë dhe të demokracisë, **siç e kemi pasur zakon gjithmonë**, do t'i nderojmë përherë.*
- ***Siç ka thënë Naimi**, gjuha shqipe është gjuhë e pasur.*
- *Gjithashtu, **duhet thënë**, poezia ndikon shumë në ndjenjat e njeriut.*

4. Fjalitë e ndërshtëna (ndërkallura)

Fjali të ndërshtëna (ndërkallura) quhen ato fjali që kanë të dhëna të ndryshme plotësuese për njëfjali apo fjalë të porsathënë dhe që kanë intonacion të veçuar.

- *Edhe kur dilte jashtë - **kjo ndodhte rrallë** - nuk e ndiente veten mirë.*
- *Priti në heshtje (**edhe një sekondë i dukej gjatë**) pastaj filloi të ecte.*
- *Me dhjetëra gurnecka - **sikundër i quajnë në Pogradec** - iu sulën grepit.*
- *U hodhi një sy shënimeve - **gjë që nuk i ndodhte shpesh** - dhe filloi të fliste.*

GRUPET KRYESORE TË FJALISË :

KRYEFJALA DHE KALLËZUESI

Fjalja, nga pikëpamja strukturore, përbëhet nga dy grupe:

- nga grupi emëror
- nga grupi foljor,

ndryshe, siç e quajtëm te kreu i sintagmës,

- nga sintagma emërore (SE)
- sintagma foljore (SF),

për shembull në fjalinë:

Autobusët e turistëve kishin qëndruar te hyrja e hotelit.

autobusët e turistëve

është sintagmë emërore,

kishin qëndruar te hyrja e hotelit

është sintagmë foljore.

Secili nga grupet e mësipërme ka një qendër organizuese,

sintagma emërore ka emrin autobusët që kryen funksionin e kryefjalës,

sintagma foljore ka foljen *kishin qëndruar* në funksion të *kallëzuesit*.

Kryefjala dhe kallëzuesi janë gjymtyrët kryesore të fjalisë dhe fjalia që i përmban të dyja, quhet fjali **dykryeqjymtyrëshe** (dyshe).

Marrëdhëniet që vendosen midis kryefjalës dhe kallëzuesit, janë marrëdhënie kallëzuesore (ose predikative) dhe lidhja midis tyre është kallëzuesore.

KRYEFJALA

Kryefjala është gjymtyra kryesore emërore apo përemërore e fjalisë, që hyn në marrëdhënie dhe lidhje kallëzuesore me kallëzuesin.

Kryefjala shprehet

- me emër,
- me përemër,

- me numëror,
- me çdo pjesë të ligjëratës të emërzuar,
- me sintagmë.

Rasa tipike e kryefjalës është **rasa emërore**.

Ajo nuk merr parafjalë, p.sh.:

***Njerëzit** shpeshherë nuk e kuptojnë të tashmen.*

***Patriotët shqiptarë** themeluan shtetin tonë një shekull më parë, më 28 Nëntor 2012.*

➤ **Kryefjala e shprehur me emër.**

Emri në funksion të kryefjalës mund të jetë i shquar ose i pashquar.

- Emri *në trajtën e shquar*, rasa emërore, është forma më tipike dhe më e përdorshme e shprehjes së kryefjalës. Në këtë funksion emri mund të jetë i përgjithshëm a i përveçëm, mund të ketë çfarëdo kuptimi leksikor dhe të përdoret në çdo tip fjalie.

***Vjollca** mbuloi fytyrën me duar.*

*Kishte rënë **nata**.*

*Ç'mendonin **njerëzit**?*

*Se ç'mund të bënte **atdheu** për të.*

*Pas pendimit vinte **rënia** shpirtërore.*

- Përdorimi i emrit *në trajtë të pashquar* si kryefjalë e fjalisë ka të bëjë me tipin e fjalisë (nëse është fjalia dëftore a pyetëse, pohore a mohore), me kuptimin e emrit në funksion të kryefjalës.

Emri i pashquar si kryefjalë përdoret në fjali që kanë kallëzues të shprehur me folje joveprore (pësore, vetvetore, mesore).

*Mësuesi kërkoi të mbahej **qetësi**.*

*Ishte dimër binte **borë**.*

Emri i pashquar si kryefjalë përdoret në fjali dëftore, pyetëse etj. qofshin këto pohore apo mohore, me folje kallëzues të çdo diateze :

*Kudo thureshin **legjenda** për trimëritë e saj.*

***Mendime** të befta e të panjohura i shfaqeshin si një mjegull në kokë.*

*Frynin **erëra** e binin **shira** pa pushim.*

➤ **Kryefjala e shprehur me përemër.**

Të gjithë përemrat mund të jenë kryefjalë, ashtu sikurse emrat, për shembull:

***Ne** jemi vëllezër të një gjuhe e të një gjaku.*

*Këtë e arriti **ajo** e para.*

- *Përemri vetor përdoret si kryefjalë në çdo vetë e në çdo numër.*

Përemri vetor i vetës I dhe II përdoret si kryefjalë kryesisht kur mbi të bie theksi logjik ose vihet në dukje me anë të kundërvënies.

***Ai** e vështroi me ëmbëlsi.*

***Unë** s'jam nga ata.*

*Edhe **unë** ashtu e di.*

***Ti** na recitove vargje nga poema “Bagëti e bujqësi” e Naimit?*

- Nga përemrat dëftorë përdoren si kryefjalë përemrat **ky**, **ai** që tregojnë përkatësisht sende apo frymorë, afër ose larg, në të dyja gjinitë dhe në të dy numrat. Në një fjali të përbërë, dëftori në funksion të kryefjalës mund të rimarrë përmbajtjen e fjalisë që ndodhet para tyre, me qëllim theksimin e saj.

***Kjo** e dëshpëronte shumë djalin e vogël.*

***Këto** ishin udhëtime të bukura.*

*Një nga ata ishte dhe **ai**.*

***Ata** që po vinin ndaluan një çast.*

- Kryefjala shprehet edhe me *përemrat e pacaktuar*, si: *kush, dikush, sekush, gjë, gjësendi, një, ndonjë, ndonjëri, secili, kushdo, cilido, tjetërkush, ca, disa, shumë, pak, aspak, askush, asnjëri, asnjëri, asgjë*:

*Përsëri nuk u përgjigj **kush**.*

***Dikush** trokiti në derë.*

***Një** që s'punon nuk mund tëshkojë përpara.*

*Në fund foli **njëra**.*

- Kryefjala shprehet edhe me *përemrat lidhorë të caktuar e të pacaktuar*, në përbërje të një fjalie me nënrenditje :

***Kush** ka për të ardhur, le të dalë jashtë.*

Ç'vinte më pas e mora me mend.

*Asnjë dritë nuk dukej në shtëpizat **që** humbnin në mes të ullinjve.*

➤ **Kryefjala e shprehur me numëror.**

Numërorët themelorë me përdorim emëror mund të kryejnë funksionin e kryefjalës.

*Si s'doli **një** t'i thoshte një fjalë.*

***Dy** mungojnë sot, **tre** mungonin dje.*

***Që të tria** ndjenë të njëjtën kënaqësi.*

➤ **Kryefjala e shprehur me pjesë të tjera të ligjëratës të emërzuar.**

Kryefjala mund të shprehet me çdo pjesë të ligjëratës të emërzuar. Si çdo emër,

- mbiemrat e emërzuar,
- përemrat dëftorë *i këtillë, i atillë, i tillë*,
- përemri i pacaktuar *tjetër*

të emërzuar, në funksion të kryefjalës përdoren në trajtë të shquar dhe në trajtë të pashquar.

***E reja** nuk çan aq lehtë.*

Të vegjlit hidheshin nga gëzimi.

I pari kaloi lirshëm, kurse i dyti mbeti.

Grupe të rinjsh thërmonin tokën me shat, të tjerët lessonin.

Të tilla takoheshin më rrallë.

Ndërkohë që përdoren si kryefjalë edhe përemrat pronorë të emëruar, të cilët për shkak të kuptimit të tyre, përdoren gjithnjë të shquar.

Po të tutë a janë atje ?

Imi s'është kënaqur akoma.

Po kështu si kryefjalë përdoren edhe përemrat pyetës të emëruar :

Pse-ja mbeti pa përgjigje.

➤ **Kryefjala e shprehur me një sintagmë.**

Në funksion të kryefjalës mund të dalë edhe një sintagmë emërore. Një tip i sintagmës emërore që shërben si kryefjalë është ajo që ka kokë një emër të pashquar dhe si specifikues të kokës një përemër ose një mbiemër si plotësor. Këto sintagma ndërtohen :

- Përemër dëftor *ky, kjo, ai, ajo* + emër të pashquar.

Kjo elitë s'kishte të bënte me ata.

U desh të ndodhte ajo gjë e tmerrshme.

Të gjithë këta njerëz ishin vërvitur me javë të tëra.

Klithmën e gëzueshme e prishi ky mort i madh.

- përemrat e pacaktuar *njëfarë, gjithfarë, lloj-lloj, gjithfarëlloj, çfarëdo* apo nga përemri pyetës *çfarë* + një emër të pashquar në rasën rrjedhore :

Gjithfarë gjërash i shkuan në mendje.

Atij i lindi njëfarë dyshimi.

Dëgjoheshin lloj – lloj fjalësh.

Zefi e merrte me mend se çfarë njerëzish do të vinin aty.